



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:019694

Datë: 29.07.2020

Numri i dokumentit: 01044199

P.nr.1531/2019

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Vjollca Buzhala, me sekretaren juridike Drita Baftjari, në çështjen penale të akuzuarit M.Xh nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të Kodit Penal i Republikës së Kosovës (NR. 04/L-082), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2876-4/2017 të datës 16.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e prokurorit shtetit Musli Gashi, të dëmtuarit A.Vdhe të akuzuarit, me datë 14.07.2020 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.Xh nga i ati I. dhe e ëma V. e lindur H., i lindur me datë ... në Prizren, ku edhe tani jeton në lagjen “...” ka të kryer shkollën e mesme me profesion fasader , i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPK.

LIROHET NGA AKUZA

Me datë 20.09.2017 rreth orës 17:38 minuta, në Prizren, në rrugën “...” pikërisht në parkingun e qendrës tregtare “...” i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të dëmtuarit A.V në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke e parkuar automjetin e godet të njëjtin me një shufër metalike-mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor apo dëmtim të rëndë trupor apo dëmtimi të rëndë të shëndetit në pjesët e ndryshme të trupit, ne ç rast me këto veprime i shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto me afër të konstatuara me mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, Dr. F.B të dhënë me dt.07.11.2017.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPK.

Për shkak se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

I dëmtuari A.V nga fshati ..., Komuna e Prizren, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2876-4/2017 të datës 16.11.2017, kundër të akuzuarit M.Xh nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me pare 1 pika 1.4 të KP-së.

Pas administrimi të të gjitha provave në këtë qështje penale, ndaj të akuzuarit M.Xh, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se e ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me pare 1 pika 1.4 të KP-së, gjakata në munges të provave ,në kuptim në kuptim të nenit 364, paragrafi 1 pika 1.3 të KPPK-së, të akuzuarin e ka liruar nga auza.

Në bazë të ankeses së të Prokuroris Themelore në Prizren, në gjykatën e apelit, është anuluar aktgjykimi P.nr.2042/17, i datës30.10.2017 dhe qështja është kthyer në rivendosje me arsyetimin që shpallja e aktgjykimit nuk është bërë në kuptim të dispozitave të KPP-së.

Gjykata sipas sygjërimeve dhe vërejtjeve të gjykatës së apelit, me datën 10.02.2020 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës hyrëse të datës 29.05.2018.

I akuzuari M.Xh në fjalën hyrëse ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës hyrëse të datës 29.05.2018.

Kompetenca e gjykates -

Gjyqtari ka vlerësuar se Gjykata Themelore në Prizren, duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të KPPK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se veprat penale janë kryer në Prizren, që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate.

Kompetenca lëndore - Duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku i akuzuari M.Xh akuzohet se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KP-së, ku për këtë veprë penale parashihet dënim me burgim deri në tri (3) vjet, po ashtu këto vepra penale nuk janë përfshirë në nenin 22 të KPPK-së.

Provat personale të dministruara.

Gjykata me propozimin e palëve ka lexuar deklaratat e të dëmtuarit A.V, dëshmitarëve M.S, A.G, G.Xh, B.B dhe B.R nga shqyrtimi paraprak.

- Dëshmia e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit A.V
 - Dëshmia e të dëshmitarit- G.Xh
 - Dëshmia e të dëshmitarit- M.S
 - Dëshmia e të dëshmitarit- B.R
 - Dëshmia e të dëshmitarit- A.G
- Është bërë shiqimi në në deklaratën e të dëmtuarit, dëshmitarëve, dhe të pandehurit të dhënë në procedurë paraprake pranë Stacionit Policor në Prizren.

I dëmtuari në dëshminë e tij dhënë para gjykatës me datën 29.05.2018 ka deklaruar se në ditën kritike ka shkuar në Qendrën tregtare “...” me qëllim që të furnizohet me material për lokalin e tij rreth orës 17:10 minuta, ku gjatë marrjes së “kolicës” ka hasur në dy persona të përgatitur të cilët e kanë gjuajtur me shufër metalike prej mbrapa, ku nga ta pretendon se ka njohur vetëm M.Xh i cili e sulmon me shufër metalike të cilët kanë qenë me maskë dhe për shkak të zënkave të më përparshme pretendon se e ka goditur tani i akuzuari por që deklaron se asnjë herë nuk e ka parë fytyrën e të akuzuarit.

Dëshmitari G.Xh në dëshminë e tij dhënë para gjykatës me datën 04.12.2018, ka deklaruar se është punëtor tek babai i të akuzuarit nuk ka njohuri për rastin nuk ka dëgjuar edhe se ka kuptuar për këtë rast nga ftesa e Gjykatës.

Dëshmitari M.S në dëshminë e tij dhënë para gjykatës me datën 04.12.2018, ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në parking të qendrës tregtare “...” në kohën kur është rrahur Arbeni aty ka qenë nga ajo që ka arritur të vërej ka parë se është goditur nga një person i cili ka qenë i shoqëruar nga një person tjetër i cili ishte me një motor por që nuk mund të identifikoj personin dhe motorin.

Dëshmitari B.R, në dëshminë e tij dhënë para gjykatës me datën 04.12.2018 ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në orare të punës së bashku me të akuzuarin ku ka punuar në Fushë Kosovë por data e saktë nuk i kujtohet ku kanë qenë duke punuar 10-15 punëtor, së bashku me ta ka qenë duke punuar edhe i akuzuari, njëherit nuk kanë udhëtuar pasi që kanë fjetur në Prishtinë, në shtëpinë e M.Xh, njëherit nuk i kujtohet se ditën kritike se a ka qëndruar i akuzuari me ta por deklaron se ai ka pasur dhomën e tij në shtëpi dhe deklaron se nuk ka motor skuter.

Dëshmitari A.G, në dëshminë e tij dhënë para gjykatës me datën 25.02.2019 ka deklaruar se punon taksist që 10-12 vite dhe pikën e qëndrimit e ka te ...-ja në ditën kritike ka qenë përlëshja, për derisa ka qenë në veturë me kolegun e tij M.S, në ato momente ka dëgjuar njëfarë zhurmë, së bashku me shokun e tij kanë vrapuar dhe vetëm kur kanë parë një person i cili ka qenë duke e goditur me diçka një djalë tjetër por me çka e ka goditur nuk e di, kur e ka goditur ka qenë vetëm një person ndërkaq kur kanë ikur i kam vërejtur dy persona të cilët ishin të maskuar andaj edhe nuk ka mundur ti identifikoj.

Leximi i shkresave- Provat materiale

- Është bërë shiqimi në raportin mjekësor të Spitalit Regjional të Prizrenit- qendra Emergjente e dt. 20.09.2017 në ora 17:35 minuta për të dëmtuarin A.V me nr. të protokollit ...të lëshuar nga Dr. H.V;
- Është bërë shiqimi në ekspertizën mjeko –ligjore nga Dr. F.B të dhënë me dt. 12.11.2017 në emër të dëmtuarit A.V;
- Është bërë shiqimi në raportin fillestar të incidentit të dt.20.09.2017 me nr. të rastit 2017 ...;
- Është bërë shiqimi në në raportin e Oficerit të dt. 20.09.2019 me nr. të rastit 2017 GA ...; Shikimi në CD-ën nga parkingu i ...-ës.

Deklarimi i të akuzuarit

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 14.07.2020, i akuzuari M.Xh në mbrojtjen e tij, ka deklaruar se mbetet në tërësi ran mbrojtjes së tij në proqesverbalin e datës 03.05.2019 dhe ka shtuar se ditën kritike ka qenë në Prishtinë, në punë, e ka njoftuar prindi-babai në telefon dhe i ka thënë “policija janë të shtëpija dhe janë duke e kqyrë motorrin”, por motorri ka qen i pa

përdorur afërsisht një (1) vit, kështu që policija kanë konstatuar se nuk është motorri për të cilin ata kanë dyshuar.

Elementet e veprës penale

Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 nën par 1.4: Kur vepra penalenga paragrafi 1i këtij neni krahet me armë, mjetë të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktoj lëndim të rënd trupor ose dëmtim të rënd të shendetit, krysi dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.

Fjala Përfundimtare e palëve

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të datës 12.06.2019 ku ka theksuar se: Prokuroria Themelore në Prizren me dt. 16.11.2017, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit M.Xh për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPK. Në këtë shqyrtim gjyqësor kundër të pandehurit janë dëgjuar një zër dëshmitaret si dhe janë administruar provat tjera materiale. Në bazë të ekspertizës mjeko-ligjore të Dr. F.B është konstatuar se i dëmtuari A.V ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe atë ndrydhje të indeve të buta të shpinës dhe plagë shpuese në bërrylin e dorës së majtë, lëndime të shkaktuara nga veprimi mekanik të mjetit të fortë jo të mprehtë, në bazë të CD-së –inçizimit të vendit të ngjarjes është vërtetuar se si këto i akuzuari dhe një person tjetër i pa njohur me një motor në parkingun e ...-së ku personi i pa njohur qëndron në motor ndërsa i akuzuari edhe pse me një helmet në kokë dhe me një shufër i afrohet të dëmtuarit dhe të njëjtin e godit në pjesë të ndryshme të trupit. Në këtë shqyrtim gjyqësor është dëgjuar edhe dëshmitari G.Xh i cili nuk qen në gjendje të deklarohet të konstatoj se ditëm kritike ka qenë së bashku me të pandehurin apo jo, ndërsa dëshmitari Mirsad Sope i cili ka qen dëshmitar okular në vendin e ngjarjes ka deklaruar se ai ka par rrahjen se si ka ndodhur dhe ky konstatim i tij është në përputhje edhe me përshkrimin e gjendjes faktike në aktakuzë. Gjithashtu në këtë shqyrtim është dëgjuar edhe B.R i cili nuk ka qen në gjendje të deklarohet lidhur me alibinë e të akuzuarit se ditëm kritike i akuzuari dhe dëshmitari B.R ka qen në Fushë Kosovë duke punuar apo ka qen në një vend tjetër. Ndërsa dëshmitari A.G i cili është dëshmitar okular i vendit të ngjarjes ka parë tërë ngjarjen dhe ka qenë në gjendje të përshkruaj rastin siç përshkruar në aktakuzë, dhe në fund i dëmtuari A.V në këtë mënyrë bindëse ka deklaruar se ka parë dy persona, ndërsa vetëm njërin e ka njohur ndërsa personin tjetër nuk e ka njohur dhe i njëjti ka deklaruar se ky person edhe pse ka qen në me helmet në kokë është këtu i akuzuari M.Xh, i njëjti ka deklaruar se ai personalisht nuk ka pasur probleme me ndonjë person por i njëjti ka deklaruar se babi i akuzuarit ka pas problem me mua andaj ka ardhur edhe deri te rrahja, i njëjti ka deklaruar është i bindur se i akuzuari e ka goditur me një shufër për shkak se i akuzuari edhe më herët rreth 3-4 herë e kishte përcjellur të dëmtuarin në ...- së dhe në fund i njëjti ka deklaruar se arsyeja se pse i akuzuari ka pas problem me të dëmtuarin është se babai i të pandehurit është rrahur dhe të njëjtit kanë menduar se punëtorët e të dëmtuarit e kanë rrahur të njëjtin, andaj në bazë të gjitha atyre që u cekun më lartë propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari A.V, në fjalën përfundimtare ka theksuar se në tërësi e përkrah fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, e ndjen vetin të dëmtuar dhe ka parashtruar kërkesen pasurore-juridike.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari M.Xh ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të datës 12.06.2019 ku ka theksuar se: unë personalisht nuk kam pasur asnjëherë punë me A.V, të njëjtin vazhdimisht e kam parë edhe në qytet, të njëjtin e kam parë edhe në Bazhdarhane arsyeja pse e cekë saktësisht ... nuk e kam afër shtëpisë time, ne pas

dashur që unë të bëj diçka e kisha bërë shumë lehtë afër shtëpisë sime e jo të shkoj në oborr të ...-së sipas mendimit të tij, nuk është e vërtetë se me të njëjtin babi im ka pasur ndonjë problem me të njëjtin nuk kam dashur me pasur punë asnjëherë, nuk e ndiej vetën fajtor për këtë vepër penale me të cilën akuzohem, me vjen keq për A.V si viktimë mirëpo këtë vepër unë nuk e kam kryer.

Vlerësimi i provave

Gjykata i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor një nga një dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku dhe ka ardhur në përfundim se: në veprimet e të akuzuarit M.Xh nuk janë krijuar elementet qenësore të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2 lidhur me nenin 1. nën par 1.4 të KPK- së, pasi që prokuroria nuk ka qenë në gjendje që të ofroi prova të mjaftueshme që do ta vërtetonin fajësinë e të akuzuarit.

Kjo nga fakti se me asnjë provë bindëse nuk u vërtetuar se këtu i akuzuari M.Xh i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor A.V.

Gjendjen e këtyllë faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të deklaratave mbrojtjes të akuzuarit, të cilës deklarat gjykata ia fali besimin e plotë, ngase deklaratat e tij është në përputhje të plotë edhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si të atyre personale ashtu edhe atyre materiale.

I akuzuari në mbrojtjen e tij, para gjykatës deklaruar se ditën kritike ka qenë në Prishtinë, në punë, nuk ka qenë në Prizren, me të dëmtuarin A.V personalisht asnjëherë nuk ka pasur asnjë problem, atë ditë e ka njoftuar prindi-babai në telefon dhe i ka thënë “policija janë të shtëpia dhe janë duke e kqyrë motorrin”, por motorri ka qenë i pa përdorur afërsisht një (1) vit, kështu që policija kanë konstatuar se nuk është motorri për të cilin ata kanë dyshuar.

Deklarata e të akuzuarit mbështetet edhe nga deklaratat e dëshmitarit M.S dhe A.G, të cilët në dëshmit e tyre pran gjykatës kanë deklaruar se ditën kritike kanë punuar si zakonisht si taksista për një moment kanë dëgjuar një zhurm, së bashku kanë vrapuar dhe vetëm kur kanë parë një person i cili ka qenë duke e goditur me diçka një djalë tjetër por me çka e ka goditur nuk e di, kur e ka goditur ka qenë vetëm një person ndërkaq kur kanë ikur i kanë vërejtur dy persona të cilët ishin të maskuar andaj edhe për asnjë moment nuk ka qenë e mundur të identifikohet personi që e ka goditur djalin.

Edhe nga shiqimi në CD-en, nga parkingu i dt.20.09.2017 duke filluar nga ora 17 e 27 minuta e 37 sekonda, në të cilën vërehen fillimisht se si dy persona të cilët qëndronin në një motor, njëri ngelë në motor ndërkaq tjetri person me maskë sulmon një person tjetër, pastaj të dy personat me maskë hypin në motor dhe largohen nga vendi i ngjarjes në drejtim të pa njohur, nga shiqimi i CD- es, nga ana e të pranishmëve në sallë është shikuar tri herë, nga shiqimi i kësaj CD - es, për asnjë çast nuk vërehet fytyra e personit i cili e ka sulmuar viktimën, nga shiqimi i CD – es, mund të vërehet vetëm fytyra e të dëmtuarit – viktimës.

Edhe prokurori i shtetit lidhur me CD – en, ka deklaruar se asgjë konkret nuk ka mundur të vërej për veq se shihen dy persona të cilët hypin në motor dhe largohen nga vendi i ngjarjes, me ç’rast njëri paraprakisht e sulmon një person ndërsa tjetri qëndron në motor dhe pasi që e përfundon sulmin ndaj të dëmtuarit kthehet në motor dhe së bashku të dytë largohen nga vendi i ngjarjes, në baze të shiqimeve nuk mund të identifikohet se kush janë këta dy persona pasi që në kokat e tyre kanë të vendosura maskat apo helmetat.

Një fakt të till e ka vërtetuar edhe i dëmtuari i cili pas shiqimit të CD-es, ka deklaruar se : për asnjë moment nuk mund të shihet fytyra e dy personave, as fytyra e njërit person i cili e ka sulmuar, në CD nuk vërehet sulmuesi, por vetëm trupi i të dëmtuarit shihet i cili rrëzohet për tokë, i dëmtuari deklaroi se ditën kritike për asnjë moment nuk ka parë fytyrën e këtu të akuzuarit M.Xh duke e goditur , arsyeja pse e ka akuzuar M. është për shkak të një problemi të mëhershëm.

Vlen të theksohet se gjykata duke i analizuar provat veç e veç dhe lidhmërinë e provave në tërësi, gjeti se të gjitha provat e arsyetojnë se i dëmtuari në ditën kritike është sulmuar nga një person i cili ka qenë i shoqëruar me një person tjetër i cili ka ndihmuar sulmuesi duke pritur me motor të dy personat kanë qenë të maskuar , sulmuesi i ka shkaktuar lëndime të lehta i cili fakt gjykata e vërteton me raportin mjekësor të Spitalit Regjional ... –Qendra Emergjente e dt.20.09.2017 në ora 17:35 minuta për të dëmtuarin A.V me nr. të protokollit 11274 të lëshuar nga Dr. H.V, si dhe nga ekspertiza mjeko ligjore nga Dr. F.B të dhënë me dt.12.11.2017 në emër të dëmtuarit A.V si dhe nga raporti fillestare të incidentit të dt. 20.09.2017 me nr. të rastit ..., po ashtu nga shiqimi në CD-en nga parkingu i ...-së si dhe nga deklaratat e të dëmtuarit , dëshmitarëve të dhëna në procedurë paraprake pranë Stacion Policorë në Prizren.

Gjykata ka analizuar dëshmitë e dëshmitarëve dhe të dëmtuarit dhe asnjëri nuk ka arrit që të bëjë identifikimin e të akuzuarit M.Xh si shkaktues të veprës penale ndaj të dëmtuarit A.V, deklaratimet e të dëmtuarit se e akuzon M.Xh për shkak të një problemi të mëparshëm, gjykata kësaj deklarate nuk mund t'ia falë besimin pasi si e tillë nuk mund të provon fajësinë e të akuzuarit sepse është në kundërshtim me të gjitha provat tjera.

Pas administrimit

Gjykata duke i analizuar provat veç e veç dhe duke i nderlidhur të gjitha së bashku ka ardhur në përfundim a se në veprimet e të akuzuarit M.Xh, nuk janë formuar elementet qenësore të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me parë 1 pika 1.4 të KP-së, në mungesë të provave gjykata e lirojë të akuzuarin nga aktakuza në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 364 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2018:019694, 29.07.2020

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.